



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

Kuvendi Komunal

01 Nr.06-4062/4

Dt.31.03.2016

D r a g a s h

Në bazë të nent 12, paragrafi 12.2. pika d) dhe nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/25 qershor 2008), nenit 7, paragrafi 3 të Ligjit 04/L-144 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës Komunale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.35/17 dhjetor 2012), të dhe të nenit 32, paagrafi 32.2 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt.11.09.2008, pas shqyrtimit paraprak të Propozimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.31.03.2016, miraton këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS NË PRONËSI KOMUNALE

- I. **MIRATOHET** Propozimi i Kryetarit të Komunës së Dragashit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër (nga 1 deri në 15 vjet) të pronës në pronësi të Komunës – 3 lokale në Dragash që gjenden në parcelën kadastrale 781 në listën e njësive UL-70604014-00179, personave fizik e juridik, si vijon:
 - 1.1. Lokali me depon i cili, më parë, ka qenë në shfytëzim nga "Pro Credit-Bank"-Dega në Dragash,
 - 1.2. Lokali i ndarë në dy lokale nr.2/1 ku ushtrohet veprimaria farmaceutike(barnatore) me sipërfaqe 44 m/2, dhe
 - 1.3. Lokali i cili gjendet në objekin e ndërtesës së banimit në sipërfaqe 60 m/2, përfshi edhe depon.
- II. Për shkak të natyrës së objekteve dhe banuesëve, në lokale nuk mund të vendoset skara.
- III. Procedura e dhënies në shfrytëzim do të bëhet përmes Ankandit Publik, që zbatohet përmes Zyrës së Prokurimit e-Dragash, në bashkëpunim me Drejtoratin e Ekonomisë, Financave e Zhvillimit-Dragash,
- IV. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës me shfrytëzuesit e lokaleve do të rregullohen me Kontratë të veçantë të nënshkruar nga Kryetari i Komunës.
- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Komisioni i Vlerësimit të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Komunës, Kryetari i Komunës dhe organi përkatës i pronës komunale.
- VI. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës.

I dërgohet:

- Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore)-Prishtinë,
- Zyrës së Prokurimit-Dragash,
- Drejtoratit për Ekonomi, Financa e Zhvillim të Komunës-Dragash, dhe
- Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL DRAGASH



Shaban Shabani